

ARJAN SHUMELI

**DISA SHËNIME MBI TERMINOLOGJINË E AGROMEKANIKËS
NË FJALORIN E 1980-ËS**

Në fusha të ndryshme të shkencës dhe të teknikës, si pasojë e zhvillimeve tekniko-shkencore, hyjnë koncepte dhe njohuri të reja. Termat e rinj të futur në fushën e agromekanikës, siç çdo fushë tjetër e dijes, janë të shumtë. Kjo terminologji, edhe pse nga një fushë e ngushtë dijes, përcaktohet si tërësi e plotë termash. Si rezultat i zhvillimeve në bujqësi me modernizimin e teknikës bujqësore dhe automatizimin e proceseve bujqësore lind nevoja e inventarizimit të këtyre termave me synim zgjidhjen e problemeve të shumta që lidhen me njësimin dhe standardizimin e saj. Leksiku terminologjik i agromekanikës, si sistem termash¹, gjen pasqyrim të gjerë në tekste universitarë, në fjalorë terminologjikë dhe në fjalorë joterminologjikë (shpjegues). Shkalla e pasqyrimin të termave të agromekanikës në fjalorët shpjegues të shqipes është kushtëzuar nga shkalla e zhvillimit të bujqësisë në vendin tonë si veprimtari praktike dhe nga përmasat e synimet e veprës në fjalë. Kështu, p.sh., në “Fjalorin e gjuhës” (1954) takohen më shumë fjalë-terma që lidhen me veglat e krahut, pra *terma autoktonë*, ndërsa në “Fjalorin e shqipes së sotme” (1980) takohen edhe terma të rinj, edhe terma togfjalësh të fushës, të ngritur mbi bazën e kartotekës të pasur të leksikut të shqipes.

Pasqyrimi i termave të agromekanikës në “Fjalorin e shqipes së sotme” (1980)

“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980) përbën një nga arritjet më madhore të gjuhësisë shqiptare; nga lënda leksikore, frazeologjike e kuptimore që përmban, nga karakteri sistemor e normativ dhe nga niveli shkencor i zgjidhjeve leksikografike në hullinë e gjuhësisë bashkëkohore, duke shënuar një hap të madh cilësor në zhvillimin e leksikografisë shqiptare². Duke u mbështetur në një kartotekë të pasur të leksikut të shqipes, fjalori pati mundësi të zgjedhë pjesën më të mirë të leksikut të shqipes. Ky fjalor u dha vendin e merituar fjalëve e shprehjeve popullore, hodhi në qarkullim mjaft fjalë e shprehje të panjohura ose pak të njohura, dha në gjerësi strukturat kuptimore të fjalëve, duke u hapur rrugë leksikut e frazeologjisë vetjake të shqipes. Mbi

¹ A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Tiranë, 2001.

² Shih parathënie e *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1980).

të gjitha, ky fjalor ka rritje të termave të thjeshtë dhe termave togfjalësh jo vetëm brenda një zëri, por dhe me zëra të tjerë³.

Në këtë fjalor *fjalët-terma*, në shumicën e tyre, gjatë krijimit të kuptimeve të reja nisen nga kuptimi fillestar i shënuar në fjalorin e 1954-ës, duke marrë kuptime të dyta, të treta e kështu me radhë. Këto kuptime të dyta e të treta gjuha i ka të gatshme duke marrë kuptime të reja, ose duke krijuar lidhje të reja sintagmatike, të panjohura më parë, për të ndjekur edhe pasqyruar ndryshimet shoqërore⁴. Kështu, p.sh., në rastin e fjalës ‘**armaturë**’ në “Fjalorin” (1954) jepet vetëm një shpjegim “*çdo gjë që shërben si mbështetje për të mbajtur në këmbë një makinë a një ndërtesë*”. Ndërsa në “Fjalorin” (1980) jepen edhe shtatë kuptime të tjera, mes tyre edhe kuptimi i specializuar i fushës në fjalë “*pajisje, vegla dhe pjesë të vogla të makinëve e të aparateve, që shërbejnë për të punuar mirë këto*”. Më konkretisht, në të gjejmë kuptimet e poshtëshënuara: (1). **ndërt.** “*formë prej dërrasash të mbërthyer a ose prej metali, që shërben për të derdhur shtylla, trarë për të mbajtur a për të përforcuar një pjesë të një vepre që ndërtohet*”. (2) “*shufra ose pjesë metalike të lidhura si skelet ndërmjet tyre, që vihen si përforcim brenda shtyllave, trarëve, soletave etj. të derdhura me beton*”. (4) “*rreth, skelet ose kornizë (për syza, pasqyra etj.); kuti (për radio etj.)*” (5). “*raft ku vihen të mbështetura më këmbë armët, armëmbajtëse; raft për veglat e punës*” (6) **hist.** “*pajisja luftarake e një ushtari në kohët e vjetra e në mesjetë*”. (7) **muz.** “*tërësia e diezëve dhe e bemoleve, që vihen pas çelësit për të shënuar shkallën e një pjese*”.

Në këtë kontekst, nisur nga një analizë krahasuese e lëndës leksikore të vjelë, mes të tjerash, rezulton se në fjalorin e 1980-ës kanë hyrë terma të rinj e të veçantë edhe nga fusha e agromekanikës si, p.sh., *ajkëmatës, ajrues, aksesori, buldozer, copëtues, çarëse, dezinfektues, darëprerës, disk, dydhëmbësh*, etj.

Në planin fjalëformues mund të pohojmë se në shqipen e sotme mbizotëron prirja e qartë për të plotësuar nevojat e reja leksikore me mjetet e sistemit të vet fjalëformues. Kjo përbën një karakteristikë esenciale funksionale të fjalëformimit të shqipes së sotme⁵. Në këtë fjalor gjejmë të pasqyruar zgjerimin e lidhjeve mikrosistimore të termave, që dalin si pjesë të ndryshme të ligjëratës si, p.sh., *lesë-lesoj-lesim-lesohet; branoj-branim-branuar-branohet; frezë-frezoj-frezim-frezuar; plug-plugoj-plugim-pluguar*

³ V. Memisha, *Terma-togfjalësh në fjalorët shpjegues të shqipes* në “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe. Probleme dhe Detyra”. Tiranë, 2009, f. 113.

⁴ I. Zamputi, *Për përdorimin e disa fjalëve dhe shprehjeve*, Gjuha Jonë, Tiranë, 1991.

⁵ A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare. Shkencat shoqërore në shkollë*, nr. 2, 1967, f. 70.

etj. Kjo ka ardhur si rezultat i specializimit të mjeteve fjalëformuese të shqipes. Ky proces dinamik ka krijuar marrëdhënie të reja ndërmjet tipave të ndryshëm të fjalëformimit. Kështu, mund të dallohen lehtësisht formimet me anë të **-im**, **-uar**, (krhs. *frezuj-frezim-frezuar-pafrezuar, pluguj-plugim-pluguar-papluguar*) me **-or**, **-ore**, **-shëm** (krhs. *diskore-diskueshëm*) etj.

Nga analiza e mëtejshme e termave të agromekanikës në fjalorin e 80-ës rezulton se numri i fjalëve të përngjitura është rritur ndjeshëm krahasuar me fjalorin e mëparshëm (1954), si, p.sh., *ajërmatës, akullthyes, akullçarës, arrëthyes, brazdëhapës, duajlidhës, erëmatës, erëtragues, farëhedhës, dhenxjerrëse, kashtëmbledhëse, kashtënxjerrëse* etj. Në Fjalorin e 80-ës gjejnë pasqyrim edhe fjalë të huaja të cilat kanë hyrë si domosdoshmëri e emërimit të fjalëve që shprehin kuptimin e nocionit më mirë se fjala e mundshme në shqipë. Mund të përmendim terma si, *aksesor, distributor, distilues, dezinfektues, inkubator* etj.

Fjalët arkaike speciale që shënojnë sende apo almise të ndryshme janë të pranishme edhe në fjalorin e 80-ës si., **bosti** për ‘*shkop i gjatë, që përdoret për të shkundur gështenjat, arrat etj.*’, **gërraq** për ‘*shkop me një grep që përdoret për të hequr bar nga mullari, për të varur shportën në një degë kur mbledhim pemët etj.*’, **brenë** për ‘*shkop i gjatë e i trashë, që përdoret për të thurur gardhe, për të shkundur arra, ullinj etj.*’, **cekth** për ‘*maja e hekurt e boshtit të mullirit*’, **kabëz** për ‘*pjesa metalike e sheshtë në njërën anë të hostenit, që shërben për të pastruar plorin*’, **andri** për ‘*almise për të lëruar tokën dhe për të ngarë qetë*’, **araba** për ‘*karrocë e hapur, zakonisht me katër rrota, e tërhequr prej kuajsh*’, apo edhe terma për ‘*enë që mbajnë drithin*’ si **brojce**; **broke**; **çerekore** etj.

Nga ky vëzhgim mund të nxjerrim disa përfundime me interes të veçantë praktik dhe teorik për terminologjinë në fjalë. Në planin semantik një nga rrugët kryesore të pasurimit të terminologjisë është kuptimi i ri terminologjik që marrin zakonisht fjalët e leksikut të përgjithshëm si rezultat i zgjerimit ose i ngushtimit të tyre. Në Fjalorin e 1980-ës gjejnë pasqyrim të plotë jo vetëm termat e njësuar brenda fushës së agromekanikës, por edhe një mori fjalësh të zakonshme, të cilat janë ngritura në terma përmes procesit të terminologjizimit. Më konkretisht, tek shkronja **A** rezultojnë 25 terma specialë dhe 6 terma të ngritura përmes procesit të terminologjizimit, ndërsa tek shkronja **B** rezultojnë 33 terma specialë dhe 9 terma të ngritura përmes këtij procesi. Prej këtej rezulton se pesha specifike e fjalëve të terminologjizuara, pra fjalëve të ngritura në terma mbi bazën e fjalëve të zakonshme është rritur ndjeshëm, ndërsa përqindja e termave specialë është edhe më e madhe, duke përbërë grupin kryesor tipik e me peshë për leksikun terminologjik në fushën e agromekanikës. Kështu tek shkronja **B** janë ngritura në terma në fushën e agromekanikës fjalët e mëposhtme: **ballore** (krhs., *ballore e plugut*); **bandazh** (krhs., *bandazh i rrotës*); **bisht** (krhs., *bisht i lopatës*); **bllok** (krhs., *bllok i*

motorit); **brinjë** (*brinjët e shtratit*); **brisk** (*brisk shartimi*); **dhëmb** (krhs., *dhëmbët e lesës*), **këmbë** (krhs., *këmbe e shtratit*), **shtrat** (krhs., *shtrati i plugut*), **thikë** (krhs., *thika e plugut*), **hinkë** (krhs., *hinka e shumëzimit*) etj.

Interes përbëjnë ato fjalë të ngritura në terma, të cilat nga ana e tyre shërbejnë edhe si **tema prodhuese** për terminologjinë ku bëjnë pjesë (krhs., **këmbë** si ‘*pjesë e një mbështetëse*’, pra **këmbë** (*e shtratit*), ku me anë të prapashitesimit krijohet termi i prejardhur **këmbëz**, pra, “*këmbëz e belit*”. Me të njëjtën rrugë nga termi **dhëmbë** i ngritur në bazë të fjalës **dhëmbë**, pra, **dhëmbët e lesës** janë krijuar termat e prejardhur **dhëmbëz** në kuptimin **grabujë** tek **dhëmbëzat e sharrës**, **dhëmbëzak** në kuptimin e një ‘**çekiçi**’ apo edhe termi **dhëmbor** në kuptimin e një **grabuje** apo **dhëmbësi**.

Në anën tjetër, struktura kuptimore e fjalëve, nga nxirren edhe kuptimet e termave, në “Fjalorin” (1980) jepet e zgjeruar dhe e plotë, duke pasqyruar përbërësit kuptimorë të fjalës sipas parimeve themelore të hartimit të fjalorëve. Përkufizimet që u jepen fjalëve që funksionojnë edhe si terma në këtë fjalor përafrohen me kuptimet që u jepen këtyre termave në fjalorët terminologjikë. Megjithatë përkufizimet që u bëhen termave në fjalorët terminologjikë janë më të saktë e më të motivuar duke qenë se emërtim i saktë, i përpiktë i një nocioni që pasqyron një send, dukuri, cilësi, marrëdhënie, proces dallon nga njësia e leksikut të përgjithshëm pikërisht për këtë saktësi të kufijve kuptimorë⁶. Duke u nisura nga një analizë krahasuese me Fjalorin e 1954-ës për fjalën **kosore** në Fjalorin e 1980-ës jepet përkufizimi “*kosë e vogël që përdoret zakonisht për të prerë ferra, shkurre a degë të vogla pemësh; kmesë. Tehu i kosores. Pres me kosore*”, ndërsa në ‘Fjalorin terminologjik të bujqësisë’ (2006) jepet përkufizimi “*thikë e madhe me majë të kthyer si sqep, me dorezë drur’i, që përdoret për prerje ferrash, shkurre, për krasitje degësh, për harrje hardhish etj.*” Duke ju përmbajtur këtij krahasimi rezulton se përkufizimi i fjalës “**kosore**” në ‘Fjalorin e shqipës’ (1980) jepet më i plotë, me vëllim më të madh në informacionin e përcjellë, me shpjegim më të gjerë për nocionin, ku zbulohet edhe tipari themelor e funksional, pra ai i ‘*një vegle që përdoret për prerjen e ferrave, shkurreve a degëve të vogla të pemëve*’, i cili ilustron edhe me shembujt përkatës si, “*Tehu i kosores. Pres me kosore*”. Ndërsa në ‘Fjalorin terminologjik të bujqësisë’ (2006) jepet një informacion më i specializuar, një shpjegim më i përpiktë, ku dalin në pah përmbajtja konceptore thelbësore e termit, si dhe detaje më të holla për konceptin e termit si, p.sh. “*thikë e madhe*” e plotësuar me informacionin mbi formën dhe materialin ‘*me majë të kthyer si sqep, me dorezë druri*’ së bashku me qëllimin apo funksionin e veglës “*që përdoret për prerje ferrash, shkurre, për krasitje degësh, për harrje hardhish*” etj.

⁶ H. Pasho, *Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë pas çlirimit dhe pasqyrimi i saj në të dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe*, SF, nr. 1, 1984.

Duhet theksuar se qëllimi i kuptimeve të dhëna në një fjalor është që të lidhë *realien* që tregon fjala me *kuptimin*, ose të diferencojë *realiet e ngjashme*. Për të dalluar fjalët **lopatë** nga **bel** jepen kuptimet e tyre, që i lidhin me *realien*, pra në rastin e lopatës: “vegël krahu, me një pjesë të metaltë, të gjerë e pak të lakuar dhe me bisht të drunjtë, që përdoret për punë bujqësore dhe për punë të tjera”, ndërsa për **bel**: “vegël bujqësore si lopatë, me teh trekëndësh, zakonisht me një këmbëz, që përdoret për të punuar thellë tokën ose për të hapur hendek”; Në fjalor (1980) jepen me *perifrazim* termat e fushës, të cilët veçojnë disa nga përbërësit semantikë për ta rrokur më mirë atë, kështu, **kosore**: “përdoret për të prerë ferra, shkurre a degë pemësh” ndërsa **kosë** “përdoret për të kositur barin”. Në fjalor jepet edhe shpjegimi me përshkrim, së cilës i referohet fjala, p.sh., **ajkëmatës**: “**tek**. *vegël e posaçme për të matur sasinë ose dendësinë e ajkës në qumësht*”. Ky shpjegim e dallon atë nga terma të tjerë si *ajërmatës*, *lagështirëmatës* etj. Nga analiza që i bëhet termave duhet shtuar se në fjalor jepen edhe shpjegime me përshkrim dhe sinonimi si, p.sh., “**sakicë**: *sëpatë e vogël me bisht të shkurtër*” bashkë me sinonimet përkatëse “**naxhake**, **latore**”. Nga ky vështrim krahasues rezulton se numri i sinonimeve, kryesisht i atyre me origjinë dialektore apo krahinore, është shumë i lartë. Këto sinonime mbeten në këtë rrafsh dhe si të tilla nuk e mbingarkojnë sistemin, apo nuk krijojnë ambiguitete kuptimore. Kështu, në fjalor hasim një grup sinonimesh si, p.sh., “*alet-vegël-pjesë-pajisje-almise-andri –hallat*”; “*arraba-querre*”; “*ajërmatës-ajkëtore*”; “*barbull-çapës*”; “*bel-bandil-vaganë*”; “*bigaçe-furkaçe-bigë-ngakace*”; “*cakorre-sëpatë-sakice-nagaçe-dhëmbës-rashqel-grabujë*”; *grep-sfurk plehu grremç-sfurk*; etj.

Në Fjalor (1980) gjejmë pasqyrim të plotë e të gjerë një numër i lartë fjalësh speciale, të cilat lidhen me leksikun terminologjik të agromekanikës dhe me stadin të zhvillimit të bujqësisë, pra ajo që njihet si “*bujqësia me shat*”, fjalë si **parmendë** dhe **qerre**. **Parmenda** prej kohësh ka simbolizuar lidhjen e shqiptarit me kultivimin e tokës, ndërsa **qerrja** përdorej si mjet kryesor për transportin e njerëzve dhe të prodhimeve bujqësore në fushë. Edhe pse termi **autokombajnë** filloi të futej në bujqësi, termat që emërtojnë pjesët e saj nuk gëzojnë të njëjtin “*depërtim*” në fjalor, kjo sepse pjesa dërrmuese e termave të përdorur për to ishin *fjalë të huaja*. Përdorimi i gjerë i dy veglave kryesore “**parmendë**” dhe “**qerre**” solli lindjen dhe “*depërtimin*” e shumë termave në fjalorët shpjegues të shqipes, ku një pjesë janë ngritur nga niveli i fjalëve krahinore apo dialektore. Përfshirja e tyre në fjalorin shpjegues lidhet me domosdoshmërinë e pasqyrimin të atyre termave të cilët kanë fituar “*masivizim*” në përdorim. Sipas A. Kostallarit⁷ “terminologjia tekniko-shkencore filloi të kalonte kufijtë e rretheve të mbyllura të specialistëve dhe të

⁷ A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe*, SF, nr. 2, 1989.

bëhej pronë e njerëzve'. Më konkretisht, për 'qerren' jepen të pasqyruara shumë terma që tregojnë pjesët përbërëse të saj si, p.sh., "ballore e qerres", "dysHEME e qerres", "ballëz e qerres", "anësore e qerres", "bosht i qerres", "shtrat i qerres", "gishtës e qerres", "gavyell e qerres" etj. Për fjalën "pARMENDË" jepet një numër edhe më i madh fjalësh të përdorura si terma në fjalor si "grykëza e parmendës", "bishtak i parmendës", "bishtarak i parmendës", "dorak i parmendës", "bishtëz e parmendës", "bosht i parmendës", "dërrasat e parmendës", "doreza e parmendës", "shtiza e parmendës", "këmbea e parmendës", "këmbëz e parmendës", "veshëz e parmendës" etj.

Termet togfjalësh të agromekanikës të pasqyruar në Fjalorin (1980)

Në gjuhën shqipe, sikundër edhe në gjuhë të tjera, po dëshmohet një rritje e numrit të termave togfjalësh të ndërtuar me mjete të ndryshme termformuese. Sipas V. Memishës "pasqyrimi i termave-togfjalësh në një fjalor shpjegues ka të bëjë me vetë konceptin dhe kufirin e togfjalëshit terminologjik⁸. Ndërsa për Th. Fekën 'pasqyrimi i termave-togfjalësh në një fjalor shpjegues lidhet me tipin e fjalorit, me synimet e tij, me vëllimin dhe me destinacionin e veprës'⁹. Vështruar nga pikëpamja e pasqyrimin të tyre në fjalorët shpjegues terminologjia mbetet burimi kryesor i pasurimit të leksikut të përgjithshëm¹⁰, ndaj edhe numri i ndjeshëm i termave togfjalësh në fjalorin e 1980-ës. Kjo rritje për termat togfjalësh motivohet me aftësinë strukturore semantiko-sintaksore të nivelit sintagmatik të shqipes. Përhapja e tyre ndihet në të gjitha fushat dhe nënfushat e shkencës dhe të teknikës përfshirë fushën e agromekanikës. Përdorimi i togfjalëshave, jo vetëm i jep terminologjisë karakter sistemor, të lidhur e hierarkik, por krijon saktësi e qartësi të dukshme në zbulimin e përmbajtjes së termit, sepse elementet përbërëse të tij pasqyrojnë anë të caktuara të tipareve të koncepteve¹¹. Termet togfjalësh identifikohen në Fjalorin e 1980-ës nga lidhjet që krijohen ndërmjet elementit të përcaktuar dhe atij përcaktues, të cilët në tërësinë e vet shërbejnë për të shënuar një koncept të vetëm. Si të tilla, këto lidhje përbëjnë një strukturë të hapur nga forma, por kompakte nga përmbajtja.

Kjo vërehet p.sh., në lidhjet 'plug i lehtë' dhe 'plug i rëndë', të cilat shfaqen si njësi të pavarura, ku i pari si togfjalësh i qëndrueshëm ka fituar

⁸ V. Memisha, *Termet-togfjalësh në fjalorët shpjegues të shqipes* në "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe. Problem dhe Detyra". Tiranë, 2009, f. 107.

⁹ Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikon terminologjik në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* (1980), SF, 2, 1986, f. 119.

¹⁰ Shih V. Memisha po aty.

¹¹ A. Duro, *Terminologjia si sistem*, Panteon, Tiranë, 2001.

kuptimin e një “*plugu për punime të cekëta*” duke u lidhur edhe me karakteristika fizike që ë bëjnë atë të ‘*të lehtë*’, kurse i dyti ‘*plug për punime të thella*’, duke e lidhur atë me veti fizike që e bëjnë ‘*të rëndë*’. Po kështu tek ‘*kazmë*’ kur ajo përdoret në kombinim me mbiemrin ‘*i madh*’ apo ‘*i vogël*’ duke krijuar togfjalësha të lirë ‘**kazmë e madhe**’, ose ‘**kazmë e vogël**’, ku të dyja këto njësi shënojnë objekte të vetme, që lidhen me përmasat e kazmës, të specifikuar nga mbiemrat përkatës ‘*i madh*’ dhe ‘*i vogël*’. Ndërsa tipi i togfjalëshit të qëndrueshëm ‘**kazmë shytë**’ shënon një objekt të vetëm, por me lidhje më të ngushtë elementesh përbërëse. Në togfjalëshin ‘**lopatë vetëngarkuese**’ shprehen lidhjet midis dy gjymtyrëve **lopatë** dhe **vetëngarkuese** për të shprehur llojin e **lopatës** si dhe lidhjet e këtij termi që shënon një objekt të klasës/kategorisë me të gjithë termat e tjerë që tregojnë lloje të tjera brenda klasës si, p.sh., **lopatë vetëshkarkuese**, **lopatë drejtuese**, **lopatë pastruese**, **lopatë përzierëse**, **lopatat e turbinave**, të cilat zërthehen në njësi emërtuese, duke zënë secila vendin e vet në sistemin përkatës terminologjik të fushës. Sipas A. Duros¹² lidhja e këtyre termave në sistem bëhet mbi bazën e përbashkët të koncepteve të tyre, e cila lidhet me fjalën ‘**lopatë**’. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1980) gjejmë pasqyrim këto lloje termash të fushës së agromekanikës:

1) Terma të veçuar: **a)** terma të njëkuptimshëm me përkufizimin përkatës: **kombajnë**: “*makinë e ndërlikuar bujqësore, për drithëra e për bimë të tjera, që bën njëkohësisht disa punë (korr, shin etj.) si, kombajnë korrëse e shirëse, kombajnë për vjeljen e pambukut*”; **mbjellëse**: “*bujq. makinë mbjellëse si mbjellëse misri, mbjellëse pambuku*” etj. **b)** terma të shumëkuptimshëm si, **plug**: 1) vegël 2) makinë; **shoshë**: 1) vegël 2) makinë, **lopatë**: 1) vegël 2) (makinë në kombinime si, *lopatë vetëngarkuese (vetëshkarkuese), lopatë drejtuese, lopatë pastruese (përzierëse) etj.*

2) Terma të zbuluar në strukturën semantike të fjalës: **bisht**: 1) fjalë e zakonshme 2) bisht (*lopatë*); **shtrat**: 1) fjalë e zakonshme 2) shtrat (*plugu*), **kunj**: 1) fjalë e zakonshme 2) kunj (*lese*) etj.

3) Terma togfjalësh në strukturën semantike të fjalës si njësi ilustruese: **a)** togfjalësha të lirë: *plugim i tokës, plugim i arës; mbjellje e hamullorëve, plehërim i tokës, kosa e parë, kosa e dytë etj.* **b)** togfjalësha të qëndrueshëm pa përkufizim: *plug fushe, plug kodre, plug malor, lesë e lehtë, lesë hekuri, lesë druri, kazmë shytë, kazmë me dy vesh etj.* **c)** togfjalësha të qëndrueshëm me përkufizim si, **plug i lehtë**: “*plug për punime të cekëta*”, **plug i rëndë**: “*plug për punime të thella*”, **plug mbathës**: “*plug që përdoret për të mbathur bimët*”, **plug urith**: “*plug që përdoret për drenimel*”, **bel çatall**: “*bel me teh të*

¹² Shih A. Duro po aty.

trashë e të ndarë si bigë”, **bel ulluk**: “*bel me teh të kthyer si lug që përdoret për të hapur gropë*” etj.

Pa dyshim në fushën e agromekanikës ekzistojnë probleme të tjera të shumta, që duhen trajtuar dhe zgjidhur. Por ky punim shtron nevojën për ndërmarrjen e punimeve të tjera në fusha po kaq të ngushta të dijes, të cilat për nga problematika dhe tematika posedojnë një terminologji po aq të pasur sa edhe fushat më të gjera të dijes. Këto të fundit janë bërë objekt studimi i shumë terminologëve.

BIBLIOGRAFI

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980.

A. Duro, *Terminologjia si system*, Tiranë, 2001.

A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare. Shkencat shoqërore në shkollë*, nr. 2, 1967, f. 70.

A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe*, SF, nr. 2, 1989.

H. Pasho, *Zhvillimi iterminologjisë së ekonomisë pas çlirimit dhe pasyqrimi i saj në të dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe*, SF, nr. 1, 1984.

I. Zamputi, *Për përdorimin e disa fjalëve dhe shprehjeve*, Gjuha Jonë, Tiranë, 1991.

Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”* (1980), SF, 2, 1986, f. 119.

V. Memisha, *Termt-togfjalësh në fjalorët shpjegues të shqipes* Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe. Probleme dhe Detyra. Tiranë, 2009.